



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën

Nr. 3033 Prot.

Tiranë, më 06.10.2023

V E N D I M

Nr. 41, datë 06.10.2023

PËR MARRJE MASE DISIPLINORE

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën, në bazë të nenit 10/2 dhe nenit 65/2, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, në dt.6.10.2023 shqyrtoi çështjen me:

Kërkues: Një grup prej 7 (shtatë) deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Objekt: - Marrja e masës disiplinore ndaj deputetëve Elda Hoti, Albana Vokshi, Bledion Nallbati, Zheni Gjergji, Lefter Gështhenja, Asllan Dogjani, Luan Baçi dhe Gazmend Bardhi, sipas nenit 65/1, pika 1, gërma a) dhe pika 4, dhe neni 63, pika 1 gërma d), të Rregullores së Kuvendit dhe Kodit të Sjelljes së Deputetit, neni 3, pika dh) dhe ë) dhe nenin 8, pika 2, gërma b) dhe neni 33.

- Thirrja e Mbledhjes së Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën për vlerësimin dhe marrjen e masës disiplinore ndaj disa deputetëve.

Sekretariati u njoh me kërkesën e 7 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste datë 06.10.2023 dhe u mbledh në bazë të njoftimit datë 06.10.2023 për mbledhjen në të njëjtën datë ora 16.00, bazuar në:

- Nenin 65/2, pika 1 të Rregullores që parashikon se “.... Mbledhja e sekretariatit zhvillohet brenda 48 orëve nga depozitimi i kërkesës”.
- Nenin 10, pika 5 e Rregullores që parashikon se: “....5. Rregullat e detajuara të funksionimit të sekretariateve, miratohen nga Byroja e Kuvendit”.
- Nenin 6 dhe 7 të Rregullores “Për përcaktimin e Rregullave procedurale të funksionimit të sekretariateve të Kuvendit të Shqipërisë”, miratuar me vendim të Byrosë së Kuvendit nr. 53, datë 13.05.2020, ku në nenin 6, pika 2, parashikohet se: “...2. Mbledhja e

sekretariatit si rregull thirret nga sekretari i cili përcakton rendin e ditës, datën dhe orën e zhvillimit të saj. Njoftimi i sekretarit për thirrjen e mbledhjes shoqërohet me rendin e ditës si dhe me cdo akt, informacion apo document tjetër, i cili do të merret në shqyrtim apo që u shërbën anëtarëve të sekretariatit për diskutim”; ndërsa në nenin 7, pika 1 përcaktohet se: “1. mbledhjet e sekretariatit janë të vlefshme kur në to merr pjesë më shumë se gjysma e gjithë anëtarëve të sekretariatit....”.

Në mbledhje morën pjesë 3 anëtarë të sekretariatit nga 5 anëtarë të tij, që përbëjnë kuorim e nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes. Anëtarët e tjerë njoftuan që nuk mundën të marrin pjesë në mbledhje për shkak të afatit të shkurtër të njoftimit. Nuk pati kërkesa për shtyrje të mbledhjes.

Në mbledhje u thirrën edhe deputetët për të cilët kërkohet dhënia e masës disiplinore, në zbatim të nenit 65/2, pika 2 të Rregullores së Kuvendit dhe u paraqit vetëm deputeti Z. Asllan Dogjani.

Sekretariati mori në shqyrtim kërkesën e 7 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste për marrjen e masës disiplinore për deputetët Elda Hoti, Albana Vokshi, Bledion Nallbati, Zheni Gjergji, Lefter Gështenja, Asllan Dogjani, Luan Baçi dhe Gazmend Bardhi, lidhur me situatën e krijuar pas mbylljes së diskutimeve në seancën plenare të datës 05.10.2023, ku sipas kërkesve deputetë të caktuar të opozitës me sjelljet e tyre thyen Rregulloren e Kuvendit dhe Kodin e Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, duke penguar zhvillimin normal të seancës plenare, në shkelje të parimeve të parlamentarizmit dhe normave etike të sjelljes shkaktuar nga deputetë të opozitës.

Sipas kërkesve:

- deputetët Elda Hoti, Albana Vokshi, Bledion Nallbati dhe Zheni Gjergji bllokuan vendin në sallën e seancës plenare, ku ulet Kryetarja e Kuvendit, duke penguar që të vijonte normalisht seanca plenare, pas mbylljes së diskutimeve.
- deputetët Lefter Gështenja, Asllan Dogjani, Luan Baçi në koordinim me njëri-tjetrin penguan korridorin hyrës të Kryetares së Kuvendit në sallën e seancës plenare, si dhe nuk lejuan kalimin e saj drejt vendit të vet për të njoftuar vijimin ose mbylljen e seancës plenare sipas kompetencave që i njeh ligji dhe Rregullorja e Kuvendit.
- deputeti Gazmend Bardhi e pengoi Kryetaren që të jepte njoftimet duke i hequr kartën nga pajisja elektronike gjatë fjalës së saj që po mbante në një nga vendet ulëse të Këshillit të Ministrave, në pamundësi që të fliste nga vendi i saj si pasojë e bllokimit nga deputetë të opozitës, siç përshkruhet më sipër.

Kërkesit, duke vlerësuar se veprimet e mësipërme, përbëjnë shkelje të rënda sipas Rregullores së Kuvendit, neni 65/1, pika a), (pengimi i seancës plenare, shkaktim kaosi) dhe vijnë në kundërshtim të hapur me Kodin e Sjelljes së Deputetit, pasi përbëjnë veprime të papërgjeshme, kundër normave etike për deputetin si model për shoqërinë dhe që çënojnë rëndë imazhin e Kuvendit dhe vetë deputetit në publik, kërkojnë: *Marrjen e masës disiplinore ndaj deputetëve Elda Hoti, Albana Vokshi, Bledion Nallbati, Zheni Gjergji, Lefter Gështenja, Asllan Dogjani, Luan Baçi dhe Gazmend Bardhi, sipas nenit 65/1, pika 1, gërma a) dhe pika 4, dhe neni 63, pika 1 gërma d), të Rregullores së Kuvendit dhe Kodit të Sjelljes së Deputetit, neni 3, pika dh) dhe ë) dhe nenin 8, pika 2, gërma b) dhe neni 33.*

Kërkuesit, i kanë bashkëngjitur kërkesës pamjet filmike të sallës së seancës plenare vënë në dispozicion nga shërbimet e Kuvendit, nga momenti kur Kryetarja Lindita Nikolla hyn në këtë mjedis e në vijim.

Pasi u lexua kërkesa nga sekretarja e Sekretariatit, iu dha fjala Z. Asllan Dogjani për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me këtë kërkesë. Z. Dogjani ngriti këto pretendime:

- Mbledhja e sekretariatit nuk është thirrur rregullisht dhe vjen në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit si dhe nuk janë respektuar afatet për thirrjen e saj;
- Veprimet e kryera që pretendohen shkelje për masë disiplinore ishin reagim ndaj sjelljes së mazhorancës ndaj opozitës që konsistojnë në mosrespektimin e të drejtave të opozitës;
- Masa që kërkohet nuk është në përputhje me rregulloren pasi nuk patëm asnjë paralajmërim nga Kryetarja e Kuvendit apo tërheqje vëmendje që të jepet kjo masë ekstreme;
- Mazhoranca kërkon të pengojë opozitën të ushtrojë të drejtat e veta dhe të mos e lejojë të flasë në seancën e datës 12 Tetor 2023 për rezolutën e Kosovës.

Z. Dogjani theksoi se pretendimet e parashtruara në kërkesën në shqyrtim nuk qëndrojnë, janë të pabazuara dhe të pambështetura në Rregullore ndaj kërkesa nuk duhen të pranohet.

Më tej, Sekretariati vijoi me shqyrtimin e kërkesës dhe akteve bashkëngjitur asaj. Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën, në vlerësim të sa parashtrohet në kërkesën e 7 deputetëve, pretendimeve të Z. Dogjani dhe pamjeve filmike që mori në shqyrtim dhe pas diskutimeve, vlerëson se kërkesa për marrjen e masave disiplinore ndaj deputetëve është e drejtë dhe duhet pranuar.

Fillimisht, sic është arsyetuar më sipër në këtë vendim, sekretariati nënvizon se pretendimet për thirrjen e parregullt të mbledhjes apo moszbatimin e afateve nuk qëndrojnë, pasi rezulton se referuar:

- i) nenit 65/2, pika 1 të Rregullores së Kuvendit “... Mbledhja e sekretariatit zhvillohet brenda 48 orëve nga depozitimi i kërkesës”;
- ii) nenit 10, pika 5 të Rregullores së Kuvendit, “...5. Rregullat e detajuara të funksionimit të sekretariateve, miratohen nga Byroja e Kuvendit” dhe,
- iii) nenit 6 dhe 7 të Rregullores “Për përcaktimin e Rregullave proceduriale të funksionimit të sekretariateve të Kuvendit të Shqipërisë”, “Neni 6, pika 2. Mbledhja e sekretariatit si rregull thirret nga sekretari, i cili përcakton rendin e ditës, datën dhe orën e zhvillimit të saj. Njoftimi i sekretarit për thirrjen e mbledhjes shoqërohet me rendin e ditës si dhe me cdo akt, informacion apo dokument tjetër, i cili do të merret në shqyrtim apo që u shërbën anëtarëve të sekretariatit për diskutim”; “Neni 7, Pika 1. Mbledhjet e sekretariatit janë të vlefshme kur në to merr pjesë më shumë se gjysma e gjithë anëtarëve të sekretariatit....”.

mbledhja është thirrur rregullisht, kuorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes është i pranishëm dhe janë zbatuar parashikimet e nenit 65/2, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, për njoftimin e deputetëve ndaj të cilëve kërkohet marrja e masës disiplinore.

Në lidhje me bazueshmërinë e kërkesës për marrjen e masës disiplinore:

Sekretariati vlerëson se deputetët ndaj të cilëve kërkohet masa disiplinore kanë shkelur detyrimet e nenit 65/1, pika 1, germa a) pasi kanë kryer veprime që pengojnë zhvillimin e rregullt të seancës plenare si dhe nuk kanë respektuar nenin 3, gërma dh) dhe ë), neni 8, pika 2 gërma b) të Kodit Etik - Rregullat e Sjelljes në Kuvend.

Rezulton nga pamjet filmike bashkëlidhur kërkesës se:

- deputetët Elda Hoti, Albana Vokshi, Bledion Nallbati dhe Zheni Gjergji qëndrojnë në pjesën ku është vendosur ulësja e Kryetares së Kuvendit dhe duket qartë se kjo e fundit nuk mund të kalonte për t'u pozicionuar në postin e saj e të ushtronte kompetencat për vijimin normal të seancës plenare;
- deputetët Lester Gështenja, Asllan Dogjani, Luan Baçi duket se ndalojnë kalimin e Kryetares së Kuvendit në vendin ku janë ulëset e anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe bëhen pengesë që ajo të ketë mundësi të ushtrojë tagrat që i njeh Rregullorja e Kuvendit për vijimin e seancës plenare;
- deputeti Gazmend Bardhi duket nga filmimi se ka hequr kartën nga pajisja elektronike gjatë fjalës së Kryetares së Kuvendit, në një nga vendet ulëse të Këshillit të Ministrave, (në pamundësi që të fliste nga vendi i saj, si pasojë e bllokimit nga deputetë të opozitës Elda Hoti, Albana Vokshi, Bledion Nallbati dhe Zheni Gjergji).

Të gjitha sjelljet më sipër, rezulton nga filmimet se e detyruan në fakt Kryetaren e Kuvendit, në kushtet kur duket se - nuk kishte as mundësinë minimale të bënte ndonjë thirrje për qetësim tërheqje vëmendje, apo të vijonte seancën plenare normalisht - të njoftonte mbylljen e seancës. Deputeti Gazmend Bardhi duket se i flet me ton, ndërkohë që Kryetarja për shkak të kaosit dhe situatës së paprecedentë të krijuar nga deputetët e opozitës në sallën plenare të Kuvendit, po njoftonte mbylljen e seancës.

Sekretariati vlerëson se kjo situatë është e paprecedentë dhe e papranueshme. Cdo pretendim se nuk ka patur paralajmërim përpara marrjes së masave disiplinore është i pajustificuar, sepse nga pamjet filmike, deputetët e opozitës bllokuan sallën e seancave plenare dhe krijuan një situatë kaotike, ku nuk kishte mundësi për asnjë njoftim paralajmërues ose thirrje për qetësi.

Sekretariati sjell në vëmendje se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vendimin e Dhomës së Madhe të datës 17 maj 2016, çështja "Karaesony dhe të tjerë kundër Hungarisë", aplikimet nr.42461/13 dhe 44357/13, ndër të tjera, ka mbajtur qëndrimin se:

146. Gjykata vlerëson se ekziston një interes publik mbizotërues për të siguruar që Parlamenti, duke respektuar kërkesat e një debati të lirë, të mund të funksionojë në mënyrë efektive dhe të ndjekë misionin e tij në një shoqëri demokratike.

*155. ... Sanksionet e menjëhershme (të cilat nuk janë në diskutim në rastin konkret) vendosen në rast të një çrregullimi të rëndë të rendit parlamentar dhe për sa i përket masave mbrojtëse procedurale, ato do të kërkonin një paralajmërim. **Megjithatë, mund të parashikohet gjithashtu që në raste ekstreme nuk do të kërkohet asnjë paralajmërim.** Në këtë kontekst, arsyetimi do të ishte se fjalimi ose sjellja qartazi abuzive e një deputeti anulon mbrojtjen e të drejtës së tij/saj për lirinë e shprehjes ose mund të konsiderohet si shpërdorim i së drejtës.*

Pretendimet se opozita vlerëson që nuk kish asnjë mjet tjetër, për të mbrojtur të drejtat e veta veçse të bllokonte sallën e të kryente ato veprime, sic dhe u parashtrua nga z. Dogjani, nuk vlerësohen nga sekretariati si shkak i justifikuar dhe nuk vijnë në përputhje me etikën parlamentare, çënojnë normat e Kodit të Sjelljes dhe përbëjnë sjellje jo të përgjegjshme për modelin e një deputeti. Këto situata nuk duhet të pranohen nga asnjë deputet, pavarësisht justifikimeve.

Për më tepër, sekretariati cmon se insinuata që krijohen aty për aty dhe që duken si shkaqe artificiale, për interesa politike, të qëllimshme apo jo, pa përdorur mjetet ligjore që deputetit i njej ligji dhe Rregullorja e Kuvendit janë të dëmshme dhe vijnë në kundërshtim me interesin publik. Në vend të forcës, zaptimit, e sjelljeve të papërgjeshme, është detyrë e përgjegjësi e deputetit të ndjekë parimet e parlamentarizmit, rrugën e dialogut, frymën e bashkëpunimit, ushtrimin e të drejtave që njej ligji, sepse këto janë çfarë kërkon interesi publik.

Pretendimet se mazhoranca po kërkon që opozita të mos flaës për Kosovën, nuk qëndrojnë teksa me vendimin e Konferencës së Kryetarëve datë 04.10.2023, me konsensus të gjithë grupeve politike u vendos të punohet për një rezolutë të përbashkët, të dakortësuar pozitë opozitë dhe të bëhet një diskutim në mbrojtje të interesave të Kosovës në një seancë të posacme, që do të zhvillohet në datë 12 Tetor 2023. Sjelljet e papranueshme të deputetëve të opozitës, që përbëjnë shkak për masë disiplinore ndodhën pas vendimit të Konferencës së Kryetarëve mbajtur në datë 04.10.2023. Pra është e qartë se ky pretendim nuk qëndron dhe Sekretariati shpreh keqardhje për keqpërdorimin e kësaj çështje.

Sekretariati vlerëson se situata anormale për bllokimin e veprimtarisë parlamentare nga një grup deputetësh të opozitës, sic rezulton nga pamjet filmike, pengoi jo vetëm zhvillimin normal të seancës, por pengoi edhe pjesën tjetër të deputetëve, të ushtronin me përgjegjshmëri funksionet e tyre në sallën plenare (seanca u mbyll, votimi i projektakteve u shty, në pamundësi të punohet më në seancë plenare).

Veprimtaria e çdo deputeti duhet të përshkohet gjatë gjithë kohës që ai ushtron këtë funksion nga përgjegjshmëria, ndershmëria dhe korrektesa. Deputetët nuk mund të pretendojnë cënim të të drejtave të tyre, pasi funksionimi normal i seancës plenare të Kuvendit prevalon mbi të drejtat e deputetëve, kur sjelljet e tyre vijnë në kundërshtim me Rregulloren dhe normat e Kodin e Sjelljes.

Në përfundim të sa më sipër, sekretariati vlerëson se janë kryer shkelje të rënda të etikës parlamentare nga ana e deputeteve Elda Hoti, Albana Vokshi, Bledion Nallbati, Zheni Gjergji, Lefter Gështenja, Asllan Dogjani, Luan Baçi dhe Gazmend Bardhi, duke bërë të pamundur zhvillimin normal të seancës plenare të datës 05.10.2023.

Sa më sipër Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën në zbatim të nenit 10/2, pika 2 dhe 5, nenit 63, pika 1, gërma d), nenit 65/1, pika 1, gërma a) dhe nenit 65/2 të Rregullores së Kuvendit dhe neni 8 të Kodit të Sjelljes së Deputetit, me unanimitet

VENDOSI:

1. Marrjen e masës disiplinore “Përrjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare për 10 (dhjetë) ditë” për secilin nga deputetët Elda Hoti, Albana Vokshi, Bledion Nallbati, Zheni Gjergji, Lefter Gështenja, Asllan Dogjani, Luan Baçi dhe Gazmend Bardhi, duke filluar nga data 09.10.2023 deri më datë 18.10.2023.
2. Ngarkohet “Shërbimi i Sigurisë në Kuvend” dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim mund të ankimohet nga deputeti brenda 2 (dy) ditëve pranë Byrosë së Kuvendit.
4. Ky vendim hyn në fuqi më datë 06.10.2023.

SEKRETARE

Klotilda BUSHKA

